
	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 1 deri 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

**Operatori i Sistemit të  
Transmisionit dhe Tregut  
të Kosovës  
(KOSTT)**

**Procedura e Rregullave të Tregut për  
Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e  
Matjeve**

Shkurt 2015

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 2 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Kjo procedurë e **Rregullave të Tregut** (duke përfshirë edhe amendamentet e mëvonshme) është përpiluar në përputhje me paragrafin 5.1.2 të **Rregullave të Tregut** që janë përgatitur në përputhje me Nenin 24 (paragrafi 6) të Ligjit Nr.03/L -201 për Energjinë Elektrike.

## **Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve**

### **1 Objektivat dhe Fushëveprimi**

#### **1.1 Objektivat**

1.1.1 Kjo procedurë përcakton proceset e nevojshme për të gjitha **Palët Tregtare** ashtu që të garantohet se **Të Dhënat Matëse** të dorëzuara për nevoja të **Barazimit Përfundimtar** do të:


- (a) Jenë të bazuara në regjistrimet e sakta të sasisë së energjisë që ka rrjedhë për një kohë nëpër **Sistemin Matës** ndërmjet dy pikave; ose
- (b) Jenë të përafuara përmes një metodologjie të aprovuar nga ZRRë (si kërkohet në këtë dokument); ose
- (c) Zëvendësohen me vlera të përafuara më të sakta të llogaritura në përputhje me metodologjitë e përcaktuara në këtë **Procedurë të Rregullave të Tregut**.

#### **1.2 Fushëveprimi**


1.2.1 Kjo **Procedurë e Rregullave të Tregut** përcakton principet e përgjithshme për grumbullimin, validimin, zëvendësimin dhe përafrimin e **Të Dhënave Matëse**.

1.2.2 Kjo **Procedurë e Rregullave të Tregut** përcakton proceset dhe afatet kohore që **Operatori i Rrjetit (ORr)** relevant të dorëzojë:

- (a) Për çdo **Sistem Matës të Njësive Gjeneruese**:
  - (i) **Të Dhënat Matëse Aktuale**, në përputhje me paragrafin 5.5.2 të **Rregullave të Tregut**;
  - (ii) **Të Dhënat Matëse të Përafuara**, në përputhje me paragrafin 5.5.3 të **Rregullave të Tregut**;
  - (iii) **Të Dhënat Matëse** që duhet të zëvendësojnë **Të Dhëna Matëse të Përafuara** ose **Të Dhënat Matëse Aktuale**, në përputhje me paragrafin 16.9 të **Rregullave të Tregut**;

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 3 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) Për çdo **Njësi Balancuese të Tregtarëve Ndërkufitar:**
- (i) **Nominimet Interkonektive** të konfirmuara, të cilat do të trajtohen si **Të Dhëna Matëse Aktuale** në përputhje me paragrafin 5.6.2 të **Rregullave të Tregut;**
  - (ii) **Nominimet Intekonektive** të përafuara nëse, për çfarëdo arsye, **Nominimet Interkonektive** të konfirmuara nuk janë të disponueshme, mund të trajtohen si **Të Dhëna Matëse të Përafuara**, në përputhje me paragrafin 5.6.3 të **Rregullave të Tregut;**
  - (iii) **Të Dhënat Matëse** për zëvendësimin e **Të Dhënave Matëse të Përafuara** ose **Të Dhënave Matëse Aktuale**, në përputhje me paragrafin 16.9 të **Rregullave të Tregut;**
- (c) Për çdo **Sistem Matës në Kufirin Komercial OST/OSSH:**
- (i) **Të Dhënat Matëse Aktuale**, në përputhje me paragrafin 5.7.2 të **Rregullave të Tregut;**
  - (ii) **Të Dhënat Matëse të Përafuara**, në përputhje me paragrafin 5.7.3 të **Rregullave të Tregut;**
  - (iii) **Të Dhënat Matëse** për zëvendësimin e **Të Dhënave Matëse të Përafuara** ose **Të Dhënave Matëse Aktuale**, në përputhje me paragrafin 16.9 të **Rregullave të Tregut.**
- (d) Për çdo **Sistem Matës Interval të Konsumatorëve të Kualifikuar** (të kyçur në **Rrjetin e Transmisionit** ose në **Rrjetin e Shpërndarjes**):
- (i) **Të Dhënat Matëse Aktuale**, në përputhje me paragrafin 5.8.3 të **Rregullave të Tregut;**
  - (ii) **Të Dhënat Matëse të Përafuara**, në përputhje me paragrafin 5.8.5 të **Rregullave të Tregut;**
  - (iii) **Të Dhënat Matëse** për zëvendësimin e **Të Dhënave Matëse të Përafuara** ose **Të Dhënave Matëse Aktuale**, në përputhje me paragrafin 16.9 të **Rregullave të Tregut;**
- 1.2.3 Kjo **Procedurë e Rregullave të Tregut** përcakton orarin kohor kur **AAM** duhet t'i vë në disponim për **Barazimin Përfundimtar, Të Dhënat Matëse** valide të **Njehsorëve me Lexim Interval** .
- 1.2.4 Orari kohor për agregimin e **Të Dhënave Matëse** për **Konsumatorët me Njehsor me Lexim Jo-Interval** dhe vënien e tyre në disponim për **Barazimin**

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 4 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

**Përfundimtar** është përkufizuar në **Procedurën e Rregullave të Tregut për Caktimin e Energjisë së Matur.**

### 1.3 Termet e përdorura në këtë Procedurë të Rregullave të Tregut

#### 1.3.1 Termet vijuese do të përdoren në këtë **Procedurë të Rregullave të Tregut:**

- (a) **Të Dhënat Matëse Aktuale**, janë **Të Dhënat Matëse** për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar** që rrjedhin nga të dhënat që supozohen si aktuale (në rastin e **Interkonektorit** ose **Konsumatorit të Kualifikuar** që furnizohet përmes **Njehsorit me Lexim Jo-Interval** ) ose nga leximet aktuale të **Njehsorëve** fizik;
- (b) **Të Dhëna Matëse të Përafruara**, do të jenë **Të Dhëna Matëse** për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar** që rrjedhin nga përafrimet e **Të Dhënave Matëse** për **Sistemin Matës** relevant;
- (c) **Avancimi i Njehsorit** është vlera e kalkuluar e energjisë që ka rrjedhë nëpër një **Sistem Matës** brenda një **Periode të Barazimit Përfundimtar.**
- (d) **Raporti i Të Dhënave Matëse** është raport që përmban **Të Dhëna Matëse** ose **Të Dhëna Matëse të Përafruara** për një ose më shumë **Sisteme Matëse.**

1.3.2 Të gjitha termet tjera në **bold** do të kenë të njëjtin kuptim sikurse termat e përdorura në legjislacionin në fuqi ose licenca, sipas rastit.


## 2 Principet e përgjithshme

### 2.1 Përmbledhje

2.1.1 Për çdo **Ekzekutim të Barazimit Përfundimtar**, **ORr** i nevojiten **Të Dhënat Matëse** të kompletuara për çdo **Sistem Matës**, prandaj **ORr** relevant dhe **AAM** duhet të dorëzojnë me kohë **Të Dhënat Matëse të Përafruara** (kur mungojnë **Të Dhënat Matëse Aktuale**) ose **Të Dhënat Matëse Aktuale** për **Ekzekutimin e Barazimit Përfundimtar.**

2.1.2 Pas pranimit të leximeve të **Njehsorëve**, **ORr** relevant duhet të bëjë grumbullimin dhe validimin fillestar, për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për përdorim në **Barazimin Përfundimtar.** Çdo **ORr** duhet të bëjë grumbullimin e të dhënave në përputhje me kërkesat e kësaj procedure për ato **Sisteme Matëse** për të cilat është definuar përgjegjësia e tyre për leximin e **Njehsorëve** në Nenin 7 të **Kodit të Matjes.**

2.1.3 Nëse validimi fillestar i **Të Dhënave Matëse** dështon, **Operatori i Rrjetit** mund të zbatojë një numër hapash korrigjues para përsëritjes së procesit të validimit

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 5 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

përfshirë, ri-grumbullimin e **Të Dhënave Matëse**, kur ekziston një mundësi e tillë.

2.1.4 Pasi të jetë kryer validimi fillestar, **ORr** do të bëjë zëvendësimin, kur është e nevojshme, e **Të Dhënave Matëse Aktuale** me **Të Dhënat Matëse të Përafruara** ose me **Të Dhënat Matëse Aktuale** të zëvendësuara dhe do t'ia përcjellë ato **AAM** i cili do t'i afrotojë këto të dhëna dhe do t'i vejë në dispozicion për **Barazimin Përfundimtar**.

2.1.5 Pasi që **Të Dhënat Matëse** të jenë dorëzuar për **Barazimin Përfundimtar**, këto të dhëna do të trajtohen si finale për qëllim të **Barazimit Përfundimtar** por mund të azhurnohen në qoftë se më vonë ofrohen përafime më të sakta ose ofrohen informata të sakta.

## 2.2 Njehsorët e De-energizuar

2.2.1 Para **De-energizimit** të ndonjë **Sistemi Matës**, kur një **De-energizim** i tillë rezulton me pamundësinë e **ORr** për të marrë të dhëna nga **Sistemi Matës**, **ORr** duhet të bëjë grumbullimin e **Të Dhënave Matëse** kumulative dhe **Të Dhënave Matëse** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** (në qoftë se janë të disponueshme) para dhe sa më afër kohës së **De-energizimit** të **Sistemit Matës**.


2.2.2 **ORr** do të regjistrojë leximet kumulative të **Njehsorëve** para **De-energizimit** të **Sistemit Matës** bashkë me kohën e leximit. Kur është e nevojshme, **ORr** do të përdorë këto lexime kumulative, për të llogaritur konsumin e përafruar për **Periodat e Barazimit Përfundimtar** për periudhën ndërmjet të dhënave të regjistruara nga largësia nga ana e **ORr** dhe kohës së **De-energizimit**.

2.2.3 **ORr** do të regjistrojë datat dhe kohën për të gjitha rastet kur **Sistemi Matës** është **De-energizuar** ose **Ri-energizuar**.

2.2.4 **ORr** do të tentojë të grumbullojë **Të Dhënat Matëse** nga çdo **Sistemi Matës** që është regjistruar si i **De-energizuar** në përputhje me afatet kohore vijuese :

- çdo të pestën (5) **Ditë Pune** për të gjitha **Sistemet Matëse** ku linku i komunikimit me **Sistemin Matës** është në operim.
- çdo të njëzetën (20) **Ditë Pune** për të gjitha **Sistemet Matëse** ku linku i komunikimit me **Sistemin Matës** nuk ekziston dhe nevojitet vizita në vend.

2.2.5 Nëse pas tentimit të grumbullimit të **Të Dhënave Matëse** nga **Sistemi Matës**, që është regjistruar si i **De-energizuar**, ka të dhëna që tregojnë që ka ndodhur apo është duke ndodhur konsumi i energjisë, **ORr** do të paralajmëroj **Furnizuesin** brenda 2 **Ditë Pune**. **ORr** do të hetojë rastin dhe do t'i jep udhëzime **Furnizuesit**, për aktivitetet që duhet t'i ndërmarrë brenda 5 **Ditë Pune**.

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 6 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

### 3 Grumbullimi i të Dhënave nga Njehsorët me Lexim Interval

3.1.1 **ORr** do të grumbullojë, validojë dhe regjistrojë të dhënat për **Energjinë Aktive** dhe konsumin kumulativ për të gjitha **Periodat e Barazimit Përfundimtar**, duke përfshirë edhe ndonjë alarm eventual, për nevoja të **Barazimit Përfundimtar**. Përveç kësaj, **ORr** duhet të bëjë grumbullimin, validimin dhe regjistrimin e të dhënave për **Energjinë Reaktive**, konsumin kumulativ dhe ngarkesën maksimale për të gjitha **Periodat e Barazimit Përfundimtar**, duke përfshirë edhe ndonjë alarm eventual, që nevojitet për nevoja të kalkulimit të **Tarifës për Qasje në Rrjet**.

3.1.2 **ORr** do të grumbullojë dhe validojë të dhënat matëse nga **Njehsorët kryesor** dhe ata kontrollues për të gjitha **Sistemet Matëse** që janë **Sisteme Matëse Interval**. **ORr** duhet t'ua përcjellë të dhënat përkatëse të gjitha palëve relevante:

- në kohën e specifikuar në nenin 7.2 për t'i mundësuar **OT** kalkulimin e detyrimeve për të gjitha **Palët Tregtare**, ose
- deri në orën 09.00 të **Ditës së Punës** së tretë të muajit kalendarik, pas muajit kalendarik që i takon dita për të cilën bëhet **Barazimi Përfundimtar**

cilado që të ndodhë më herët.

### 3.2 Leximi Automatik i Njehsorëve


3.2.1 **ORr** do të përpilojë një rregull për grumbullimin e të dhënave, ku çdo **Njehsor** do të lexohet me shpeshtësi të mjaftueshme për të siguruar se:

- i. që të gjitha të dhënat janë grumbulluar para se cilido regjistër të jetë fshirë me shënime të reja, dhe
- ii. që të gjitha të dhënat janë grumbulluar dhe përpunuar brenda afatit kohor të specifikuar në nenin 3.1.2

3.2.2 Kur të dhënat nuk mund të grumbullohen nga largësia, **ORr** do të vizitojë **Pikën e Kyçjes** dhe do të bëjë shkarkimin elektronik e të gjitha **Të Dhënave Matëse** brenda **3 Ditëve të Punës** nga evidentimi i problemit dhe para se çdo regjistër në **Njehsorë** të fshihet me shënime të reja, duke bërë të gjitha parapërgatitjet me palën përkatëse për qasje në stabilimente.

### 3.3 Leximet Manuale

3.3.1 **ORr** do të përpilojë një rregull për grumbullimin e të dhënave ku çdo **Njehsor** do të vizitohet me shpeshtësi të mjaftueshme për të siguruar se:

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 7 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- a) të gjitha të dhënat janë grumbulluar para se cilido regjistër në **Njehsorë** të jetë fshirë me shënime të reja, dhe
- b) të gjitha të dhënat janë grumbulluar dhe përpunuar deri në orën 09.00 të **Ditës së Punës** së tretë të muajit kalendarik, pas muajit kalendarik në të cilin bie dita, që përfshinë **Periodën e Barazimit Përfundimtar**.

3.3.2 **ORr** do të vizitojë **Pikën e Kyçjes** dhe do të bëjë shkarkimin elektronik e të gjitha **Të Dhënave Matëse**, para se ndonjë prej regjistrave të **Njehsorit** të fshihen me shënime të reja duke bërë të gjitha parapërgatitjet për qasje në stabilimentet e shfrytëzuesve të sistemit. Çdo vizitë në stabilimentet e shfrytëzuesve të sistemit ose të **ORr** duhet të realizohet në përputhje me nenin 11.


### 3.4 Leximet e Njehsorëve në rastin e Ndërrimit të Njehsorit

3.4.1 Para se të ndërrohet ose ri-programohet një **Sistem Matës**, **ORr** duhet të bëjë grumbullimin e **Të Dhënave Matëse** kumulative dhe **Të Dhënave Matëse** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** sa më afër që jetë e mundur me kohën e ndërrimit ose ri-programimit të një **Sistemi Matës**. Ndërrimi ose ri-programimi i një **Njehsori** nuk duhet të bëhet në dhjetë (10) minutat e fundit të **Periodës së Barazimit Përfundimtar** dhe do të bëhet vetëm pasi që **ORr** të ketë konfirmuar grumbullimin e **Të Dhënave Matëse** për atë **Periodë të Barazimit Përfundimtar**.

3.4.2 **ORr** duhet të regjistrojë leximet kumulative dhe kohën e çdo leximi të **Njehsorëve** para dhe pas ndërrimit ose ri-programimit të **Sistemit Matës**. **ORr** duhet t'i përdorë këto lexime kumulative të **Njehsorëve**, bashkërisht me detalet e natyrës së punëve të ndërmarrja, për të gjeneruar të dhënat e përafëruara të konsumit për **Periodën e Barazimit Përfundimtar**, gjatë së cilës janë grumbulluar **Të Dhënat Matëse** që janë ndikuar nga punimet e kryera.

### 3.5 Verifikimi i Grumbullimit të të Dhënave Matëse

- 3.5.1 Verifikimi i grumbullimit të të dhënave të **Sistemit Matës** do të bëhet sa herë që:
- i. të bëhet **Energjizimi** i parë i një **Sistemi Matës**,
  - ii. të bëhet zëvendësimi i një **Njehsori** ose **Pajisjes Primare për Ruajtjen e të Dhënave**,
  - iii. të bëhet ri-programimi i një **Njehsori** ose **Pajisjes Primare për Ruajtjen e të Dhënave**,
  - iv. të bëhet ndonjë ndryshim në ndonjë kyçje të **TMRr** ose **TMT** ose në herësin e transformimit të tyre,

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 8 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- v. një herë në çdo [tre] muaj, kur nuk mund të realizohet leximi kumulativ i energjisë nga largësia.

Kur përkohësisht është bërë **De-energizimi** i një **Pike të Kyçjes** dhe janë bërë ndryshimet e numëruara në (ii), (iii) ose (iv), do të lejohet vonesa e verifikimit të grumbullimit të të dhënave të **Sistemit Matës** derisa të bëhet **Ri-energizimi i Sistemit Matës**.

3.5.2 Sa herë që është e nevojshme të bëhet verifikimi i grumbullimit të të dhënave të **Sistemit Matës**, **ORr** do të regjistrojë, në terren, të dhënat për konsumin në atë **Periodë të Barazimit Përfundimtar** dhe do t'i krahasojë të dhënat aktuale të konsumit të marra në terren për atë **Periodë të Barazimit Përfundimtar** me të dhënat për të njëjtën periodë që janë grumbulluar si të dhëna të papërpunuara dhe pas përpunimit për të llogaritur konsumin e energjisë në kWh dhe kërkesën në kW dhe do të konfirmojë që të dhënat e grumbulluara janë të sakta ose do të caktojë ndryshimet e nevojshme në programim që nevojiten për të garantuar grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të sakta nga ana e **ORr**.

3.5.3 Ku është e nevojshme që **ORr** të bëjë ndryshimet nga largësia për programim, për të garantuar grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të sakta, atëherë duhet të bëhet verifikimi i grumbullimit të të dhënave nga **Sistemi Matës** brenda tre **Ditëve të Punës** nga dita kur janë bërë këto ndryshime në programim.

## 4 Grumbullimi i Të Dhënave për Njehsorët me Lexim Jo-Interval

### 4.1 Leximi Automatik i Njehsorëve

#### 4.1.1 Shkarkimi elektronik i të dhënave


- (a) **ORr** duhet të përpilojë një rregull për grumbullimin e të dhënave ku çdo **Njehsor** do të lexohet me shpeshësi të mjaftueshme për të siguruar:

- i. të gjitha të dhënat janë grumbulluar para se cilido regjistër të jetë fshirë me shënime të reja, dhe
- ii. të gjitha të dhënat janë grumbulluar dhe përpunuar në afatet e caktuara kohore.

- (b) Kur nuk mund të bëhet shkarkimi i të dhënave, **ORr** duhet të vizitojë **Pikën e Kyçjes** dhe të bëjë shkarkimin elektronik të të gjitha **Të Dhënave Matëse** para se regjistri të fshihet me shënime të reja duke bërë të gjitha aranzhimet e nevojshme për qasje në stabilimente me **Shfrytëzuesin e Sistemit**.

4.1.2 Të Dhënat për konsumin mujor dhe ngarkesën maksimale për të gjitha **Sistemet Matëse Jo-Interval**, që zakonisht lexohen përmes sistemit për lexim automatik të **Njehsorëve**, do të grumbullohen dhe validohen nga **ORr** dhe të dhënat do t'i



	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 9 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

përcjellën të gjitha **Palëve** relevante deri në 09.00 të ditës së shtatë të punës së muajit kalendarik pasues.

#### 4.2 Verifikimi i Grumbullimit të të Dhënave të Sistemit Matës

4.2.1 Verifikimi i grumbullimit të të dhënave të **Sistemit Matës** do të bëhet sa herë që:

- i. të bëhet **Energjizimi** i parë i një **Sistemi Matës**,
- ii. të bëhet zëvendësimi i një **Njehsori** ose **Pajisjes Primare për Ruajtjen e të Dhënave**,
- iii. të bëhet ri-programimi i një **Njehsori** ose **Pajisjes Primare për Ruajtjen e të Dhënave**,
- iv. të bëhet ndonjë ndryshim në ndonjë kyçje të **TMRr** ose **TMT** ose në herësin e transformimit të tyre.

Në rastet kur është bërë **De-energizimi** i përkohshëm i një **Pike të Kyçjes** dhe janë bërë ndryshimet e numëruara në (ii), (iii) ose (iv), do të lejohet vonesa e verifikimit të grumbullimit të të dhënave të **Sistemit Matës** derisa të bëhet **Ri-energizimi** i **Sistemit Matës**.


4.2.2 Kur është e nevojshme të bëhet verifikimi i grumbullimit të të dhënave të **Sistemit Matës**, **ORr** do të bëjë ekzaminimin e **Pajisjes Primare për Ruajtjen e të Dhënave** dy herë kur një përfaqësues i **ORr** është në terren për të bërë regjistrimin e të dhënave të konsumit. Pastaj **ORr** do të bëjë krahasimin e **Të Dhënave Aktuale** të marra në vendndodhje me të dhënat e konsumit nga **Perioda e Barazimit Përfundimtar** që i kishte grumbulluar për të njëjtën periudë si të dhëna të papërpunuara dhe pas përpunimit pasues, për të përcaktuar konsumin e energjisë në kWh dhe duhet të konfirmojë që të dhënat e grumbulluara janë të sakta ose do të bëjë ndryshime të nevojshme në programim në mënyrë që të sigurohet grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të sakta.

4.2.3 Kur është e nevojshme që një **ORr** të bëjë ndryshime në programim në mënyrë që të mundësohet grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të sakta, verifikimi shtesë i grumbullimit të dhënave të **Sistemit Matës** do të realizohet brenda tri **Ditëve të Punës** nga realizimi i këtyre ndryshimeve në programim.

#### 4.3 Leximet e Njehsorit në rastin e Ndërrimit të Njehsorit

4.3.1 Para se të ndërrohet ose ri-programohet një **Sistem Matës**, **ORr** duhet të bëjë grumbullimin e **Të Dhënave Matëse** kumulative dhe të **Të Dhënave Matëse** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** sa më afër që është e mundur me kohën e ndërrimit ose ri-programimit të një **Sistemi Matës**.

4.3.2 **ORr** duhet të regjistrojë vlerën kumulative të leximit të **Njehsorëve** para dhe pasi që **Sistemi Matës** të jetë ndërruar ose ri-programuar dhe kohën e leximit. **ORr**

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 10 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

duhet t'i përdorë këto vlera kumulative të leximit të **Njehsorëve** dhe kohën e secilit lexim. **ORr** duhet t'i përdorë këto lexime kumulative dhe informatat për natyrën e punimeve të realizuara, për të gjeneruar të dhënat për konsumin aktual ose konsumin e përafërt për **Sistemin Matës**.

## 5 Leximi Manual i Njehsorëve me Lexim Jo-Interval

### 5.1 Orari i Leximeve nga ORr

5.1.1 **ORr** do të përpilojë një orar për leximin e **Njehsorëve** për t'u siguruar që do të vizitohet çdo **Pikë e Kyçjes** ku janë të instaluar **Njehsorë me Lexim Jo-Interval** dhe ku zakonisht nuk ka sistem automatik për leximin e **Njehsorëve** në rastet kur:

- **Njehsorët** janë të pajisur me regjistruar ose indikator të konsumit maksimal, një herë në muaj deri në **Ditën e Punës** së pestë të muajit pasues.
- **Njehsorët** nuk janë të pajisur me regjistruar ose indikator të konsumit maksimal, së paku një herë në gjashtë muaj.

**ORr** do të njoftojë **Furnizuesit** për orarin e vizitave.

5.1.2 Çdo vizitë tek **Konsumatori** do të bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 11. **ORr** do të validojë dhe përpunojë të dhënat e grumbulluara në përputhje me kërkesat e nenit 7.


5.1.3 Në qoftë se **ORr** nuk është në gjendje të realizojë vizitën sipas orarit të leximeve, **ORr** do të aranzhojë me **Konsumatorin** lejen për një vizitë speciale për **Pikën e Kyçjes** së paku [një herë në vit] në rastin e matjeve të operuara me **TMRr** ose së paku çdo dy vjet në të gjitha rastet tjera.

### 5.2 Leximet e Njehsorëve në rastin e Ndërrimit të Njehsorit

5.2.1 **ORr** do të bëjë regjistrimin e vlerave kumulative dhe kohën e leximeve të **Njehsorëve** para dhe menjëherë pasi të jetë ndërruar ose programuar **Sistemi Matës**. **ORr** duhet t'i përdorë këto lexime kumulative dhe informatat për natyrën e punimeve të realizuara, për të gjeneruar të dhënat për konsumin aktual ose konsumin e përafërt për **Sistemin Matës**.

### 5.3 Leximet nga vetë Konsumatori

5.3.1 Kur kërkohet nga **ORr** ose nga **Furnizuesi** i tyre, **Konsumatori** mund të bëjë leximin për çdo regjistër të **Sistemit Matës** përmes të cilëve bëhet furnizimi i tij brenda 5 ditëve të para të çdo muaji. **Konsumatori** do të regjistrojë datën, llojin e **Njehsorit** dhe numrin serik bashkë me të gjithë regjistrat e leximeve të identifikuar me numrin ose përshkrimin e regjistratit. **Konsumatori** do të përcjellë detalet e regjistruara tek **ORr** ose tek **Furnizuesi** i tij, deri në **Ditën e Punës** të

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 11 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

pesëmbëdhjetë të muajit sipas mekanizmit të specifikuar nga **ORr** ose **Furnizuesi**.

5.3.2 Në qoftë se **Të Dhënat Matëse** i janë dorëzuar **Furnizuesit** atëherë ai duhet t'i përcjellë informatat tek **ORr** për validim dhe përpunim për nevoja të procesit të **Barazimit Përfundimtar** dhe **Tarifës për Qasje në Rrjet**.

#### 5.4 Data dhe Koha e Leximit

5.4.1 Sa herë që të dhënat merren në mënyrë manuale, data në të cilën janë bërë leximet do të regjistrohet dhe do të konsiderohet që leximet janë bërë në ora 00.00 /24.00 të datës kur janë bërë leximet.

#### 5.5 Alokimi i Energjisë për një Periodë të Barazimit Përfundimtar

5.5.1 Alokimi i energjisë për **Njehsorët me Lexim Jo-Interval** do të bëhet në përputhje me kërkesat e kësaj procedure dhe të rregulloreve të tjera relevante ashtu që energjia që konsiderohet që është konsumuar në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** për këta **Njehsorë** do të kalkulohet duke marrë në konsiderim profilin e sasisë së mbetur të konsumit pasi që të jetë zbritur energjia e matur nga **Njehsorët me Lexim Interval**.

### 6 Validimi i Leximeve të Njehsorëve


6.1.1 Në këtë nen përshkruhen hapat vijues:

- (a) **OT** u dorëzon **ORr** dhe **AAM** profilin e konsumit të energjisë elektrike për 720/744 **Periodat e Barazimit Përfundimtar** të fundit për të cilat ka bërë kompletimin e të dhënave për rrjedhat e energjisë nëpër **Pikat e Kyçjes** për të cilat ata janë përgjegjës për sigurimin e **Të Dhënave Matëse**.

Konsumi do të përcaktohet si diferencë ndërmjet të gjitha rrjedhave të energjisë që hyjnë në **Sistemin e Transmisionit** (të korrigjuara për Humbjet në Transmision) dhe shumës së të gjitha eksporteve në **Interkonektor**;

- (b) **ORr** i merr **Të Dhënat Matëse Aktuale** për **Periodat e Barazimit Përfundimtar** relevante dhe bënë validimin fillestar në përputhje me Nenin 7:


- (i) Nëse **Të Dhënat Matëse Aktuale** me sukses e kalojnë testin inicial të validimit, **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë **Të Dhëna Matëse me Validitet të Përkohshëm**;

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 12 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (ii) Nëse **Të Dhënat Matëse Aktuale** dështojnë në testin relevant të validimit, **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë **Të Dhëna Matëse me Gabim**;
- (iii) Nëse **ORr** ose **AAM** kanë arsye të dyshojnë se **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë të gabuara, atëherë **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë **Të Dhënat Matëse me Gabim**;
- (c) Pas validimit fillestar nga ana e **ORr**, **Të Dhënat Matëse** do të transferohen tek **AAM**.
- (d) **AAM** pranon **Të Dhënat Matëse Aktuale** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar** të caktuar dhe mund të realizojë validimin e dytë në përputhje me Nenin 7:
  - (i) Nëse **Të Dhënat Matëse Aktuale** me sukses e kalojnë testin fillestar të validimit, **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë **Të Dhëna Matëse me Validitet të Përkohshëm**;
  - (ii) Nëse **Të Dhënat Matëse Aktuale** dështojnë në testin relevant të validimit, **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë **Të Dhëna Matëse me Gabim**;
  - (iii) Nëse **ORr** ose **AAM** ka arsye të dyshoj që **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë të gabuara, atëherë **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë **Të Dhëna Matëse me Gabim**;
- (e) Nëse **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë **Të Dhëna Matëse me Gabim**, **AAM** do t'i kthejë këto të dhëna **ORr** relevant i cili do të përcaktojë **Të Dhëna Matëse të Përafruara** në përputhje me Nenin 7.
- (f) **AAM** i dorëzon **Të Regjistruarit** një **Raport të të Dhënave Matëse** për **Të Dhënat Matëse të Përafruara** dhe për **Të Dhënat Matëse Aktuale** (duke përfshirë edhe Validimet e tyre). **I Regjistruari** mund të përgjigjet ndaj përafrimeve të propozuara me një përafrim të reviduar dhe **AAM** do të kërkoj nga **ORr** që të dakordohet me këtë përafrim.
- (g) Në mungesë të përgjigjes ndaj **Raportit të të Dhënave Matëse** të përpiluar në hapin (c) të dhënat që janë përfshirë në raportin origjinal do të përdoren në **Barazimin Përfundimtar**.

6.1.2 **Kodet e Statusit të Leximeve të Njehsorëve** do të jenë si në vijim:

- (a) A0 – **Të Dhëna Matëse Aktuale** Valide

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 13 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) A1 – **Të Dhëna Matëse Aktuale** Valide që zëvendësojnë të dhënat e gabuara aktuale ose përafrimin paraprak të përdorur në **Barazimin Përfundimtar**
- (c) E0 – Përafrimet e gjeneruara nga **ORr** relevant
- (d) E1 – Përafrimet e dakorduara me **Të Regjistruarin**
- (e) E3 – Përafrimi i përdorur për zëvendësimin e të dhënave të gabuara aktuale ose të një përafrimi paraprak tashmë të përdorur në **Barazimin Përfundimtar**.

## 7 Validimi i Të Dhënave Matëse Aktuale

### 7.1 Konfirmimi i Kompletimit të të Dhënave

7.1.1 Para se të bëjë validimin për leximet aktuale të **Njehsorëve, ORr** duhet të konfirmojë që janë grumbulluar të dhënat komplete për një **Sistem Matës** të caktuar.

7.1.2 Para se të bëjë validimin për leximet aktuale të **Njehsorëve, ORr** duhet të konfirmojë që nuk ekzistojnë vlera zero të pa arsyeshme në të dhënat matëse të grumbulluara për ndonjë sistem matës të caktuar. Nëse ekzistojnë vlera zero të pa arsyeshme, **ORr** do të bëjë për sa është e mundur validimin e të dhënave matëse të mbetura. Në qoftë se të dhënat e mbetura kalojnë procesin e validimit ato do të konsiderohen **Të Dhëna Matëse me Validitet të Përkohshëm** dhe do të shfrytëzohen për përafrimin e vlerave zero të pa arsyeshme në përputhje me dispozitat e Nenit 9.


### 7.2 Validimi i Të Dhënave Matëse për Njësitë Gjeneruese, Kufirin OST/OSSh dhe Pikat e Furnizimit

7.2.1 Brenda 1 ditë pune (DP) pas Ditës D, **ORr** do të kompletojë shkarkimin e **Të Dhënave Matëse** nga **Sistemet Matëse** dhe do t'i dorëzojë **Të Regjistruarit** një **Raport të Të Dhënave Matëse**.

7.2.2 **Sistemet Matëse** të trajtuara me këtë nen duhet të përfshijnë **Sistemet Matëse të Njësive Gjeneruese, Pikave të Furnizimit të kyçura në Sistemin e Transmisionit ose Sistemin e Shpërndarjes dhe të ndërlidhjeve mes OST/OSSh**.

7.2.3 Validimi fillestar i **Të Dhënave Matëse** do të bëhet duke përdorur verifikimet vijuese. **Të Dhënat Matëse** do të konsiderohen **Të Dhëna Matëse me Validitet të Përkohshëm** kur :


- (a) Identifikuesi i **Njehsorit** ose lokacionit ndryshon nga identifikuesi i regjistruar në sistemin për grumbullimin e të dhënave.

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 14 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) Gabimet e **Njehsorëve** Kryesor/Kontrollues që i korrespondojnë regjistrit të **Njehsorëve** i tejkalojnë limitet në tabelën vijuese:

Lloji i Lidhjes	Regjistrat e Fuqisë Aktive			Regjistri e Fuqisë Reaktive	
	Për vlerë >5% nga vlera Max për Kanalin	Për vlerë >2% dhe ≤ 5% nga vlera Max për Kanalin	Për vlerë ≤ 2% nga vlera Max për Kanalin	Për vlerë >10% nga vlera Max për Kanalin	Për vlerë ≤ 10% nga vlera Max për Kanalin
Kyçjet ndërmjet <b>Sistemit të Transmisionit</b> dhe <b>Sistemeve tjera</b> dhe <b>Njësitë Gjeneruese ≥ 100 MW</b>	± 0.30%	± 0.50%	± 1.00%	± 3.00%	± 6.00%
Kyçjet ndërmjet <b>Sistemeve të Shpërndarjes</b> dhe, <b>Njësitë Gjeneruese &lt; 100 MW</b> dhe <b>Pikave të Furnizimit të Konsumatorëve të Kualifikuar</b> dhe <b>Pikave të Furnizimit</b> ku përcaktohen nga ana e Rregullatorit kërkohet <b>Sistem Matës Interval ≥ 10MW</b>	± 0.75%	± 1.00%	± 2.25%	± 3.00%	± 6.00%
<b>Pikat e Furnizimit të Konsumatorëve të Kualifikuar</b> dhe <b>Pikat e Furnizimit</b> ku përcaktohen nga ana e Rregullatorit kërkohet <b>Sistem Matës Interval ≥ 1MW</b>	± 1.50%	± 2.00%	± 2.50%	± 4.50%	± 9.00%
<b>Pikat e Furnizimit të Konsumatorëve të Kualifikuar</b> dhe <b>Pikat të Furnizimit</b> ku përcaktohen nga ana e Rregullatorit kërkohet <b>Sistem Matës Interval &lt; 1MW</b>	± 3.00%	± 4.00%	± 5.00%	± 4.50%	± 9.00%

- Kur në përputhje me nenin 10 është konfirmuar që një vlerë ka dështuar gjatë këtij verifikimi e që është **E Dhënë Matëse Aktuale, ORr** do të vazhdoj të realizoj këtë verifikim për të gjitha të dhënat pasuese të cilat nuk dështojnë në validim në gjashtë muajt e ardhshëm: Ky është verifikimi i vetëm që tregon se të dhënat mund të jenë jovalide;
- Limiti i gabimit të **Njehsorit** kryesor/kontrollues në çdo brez nuk ndryshon dhe


	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 15 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3. Gabimi i **Njehsorit** kryesor/kontrollues asnjëherë nuk duhet ta tejkalojë 1.5 herë limitin e saktësisë për ato pjesë të **Sistemit Matës** të cilat nuk janë të përbashkëta për **Njehsorët** kryesor dhe **Njehsorët** kontrollues.

- (c) Ekzistojnë gabime Primare/Sekondare që përcjellin kanalet gjegjëse. Do të raportohet çdo interval ku vlerat e kanaleve të krahasuara ndryshojnë në vlerën që tejkalon tolerancat e përkufizuara në **Kodin e Matjes** për shkak të ç' vendosjes së lejuar kohore. Vlerësimi mund të realizohet vetëm kur janë të instaluar **Grumbulluesit e të Dhënave** Primar dhe Sekondar dhe kur janë grumbulluar të dhënat përcjellëse. Kjo përfshin situatat kur, në konfigurimet e disa **Njehsorëve**, ekziston **Njehsori** Kontrollues Sekondar.
- (d) Gabimet kohore janë jashtë:
- (i)  $\pm 20$  sekondash në rastin e kyçjeve në **Sistemin e Transmisionit**, kyçjeve të gjeneratorëve në **Sistemin e Shpërndarjes** ose kyçjeve ndërmjet rrjetave të shpërndarjes; ose
- (ii)  $\pm 15$  minutash në rast të kyçjeve të **Furnizimit**.

Me kusht që gabimet kohore nuk janë jashtë këtyre limiteve, koha në lokacionin e **Sistemit Matës** duhet të korrigjohet nga ana e sistemit për grumbullimin e të dhënave në çdo rast kur bëhet ekzaminimi në lokacionin e **Sistemit Matës**.

- (e) **Të Dhënat Matëse** periodike janë jashtë parametrave të pritur për atë lokacion.
- (f) **Njehsorët** nuk kanë qenë në gjendje të ekzaminohen nga largësia. Dështimi i ekzaminimit nga largësia duhet të raportohet kur dyshohet se ka prishje në **Sistemin Matës**.
- (g) Gabimet krahasuese kumulative janë jashtë  $\pm 0.2\%$  kur bëhet verifikimi i krahasimit kumulativ një herë në muaj,  $\pm 0.7\%$  kur bëhet verifikimi i krahasimit kumulativ një herë në javë dhe  $\pm 5.0\%$  kur bëhet verifikimi i krahasimit kumulativ një herë në ditë. Krahasimi kumulativ paraqet mospërputhjen e avancimeve kumulative të regjistrit [gjendja e çastit] dhe shumës së periodave të **Të Dhënave Matëse** [të dhënat për Profilin e Konsumit] në të njëjtën periudë kohore.
- (h) Është paraqitur një alarm i **Njehsorit** ose një ngjarje e regjistruar në lidhje me ndryshimin e parametrave, ose ndryshimi i orës gjatë një **Periode të Barazimit Përfundimtar**, pastaj rënia e tensionit fazor, gabim në komunikim me RAM/ROM, rënie e furnizimit me energji, etj. Kur alarmi ose raporti i një ngjarje të regjistruar ka të bëjë me **Perioda të Barazimit**

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 16 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

**Përfundimtar** të caktuara, vetëm të dhënat për këto perioda do të konsiderohen **Të Dhëna Matëse me Gabim**.

- (i) Mungon ndonjë **E Dhënë Matëse** (duke përfshirë edhe verifikimin që **Të Dhënat Matëse** janë nga numri i pritshëm i kanaleve).
- (j) Kur **ORr** ka ndonjë arsye tjetër të besoj se të **Dhënat Matëse Aktuale** janë të gabuara.

7.2.4 Brenda 2 DP pas Ditës D, **Të Dhënat Matëse Aktuale** do t'i përcillen **AAM** dhe kur **Të Dhënat Matëse Aktuale** kanë dështuar gjatë validimit, **Të Dhënat Matëse të Përafuara** do të përcaktohen për të gjitha **Të Dhënat Matëse me Gabim** dhe do t'i përcillen **AAM**.

7.2.5 Brenda 3 DP pas Ditës D, **Të Dhënat Matëse Aktuale** dhe **Të Dhënat Matëse të Përafuara** do t'i dorëzohen **Të Regjistruarit** në një **Raport të Të Dhënave Matëse me Kodin e Përafimit** ku theksohet metoda e përdorur e përafimit. Lista e Kodeve të Përafimit është dhënë në Shtojcën A bashkë me metodën e përdorur për përcaktimin e përafimit.

7.2.6 **ORr** do t'i ruajë shënimet për çdo komunikim me **Të Regjistruarin** gjatë përcaktimit të **Të Dhënat Matëse të Përafuara**.

7.2.7 Brenda 5 DP pas Ditës D, **AAM** duhet të sigurojë që **Të Dhënat Matëse Aktuale** ose **Të Dhënat Matëse të Përafuara** janë të disponueshme për **Barazimin Përfundimtar**.

7.2.8 **Të Dhënat Matëse** që i dorëzohen **OT** duhet të jenë **Avancimet e Njehsorëve** të nxjerra nga **Njehsori Primar Kryesor** ose përafimet e **Avancimeve të Njehsorëve** të përcaktuara nga **Të Dhënat Matëse të Përafuara**.

7.2.9 Të gjitha **Të Dhënat Matëse** të grumbulluara nga **ORr** dhe **AAM** do të regjistrohen dhe ruhen në përputhje me **Kodin e Matjes** relevant.


### 7.3 Validimi i Të Dhënave Matëse të Interkonektorëve

7.3.1 Deri në ora 12:00 të DP të parë pas Ditës D, **OST** duhet të kompletojë shkarkimin e **Të Dhënave Matëse** nga **Sistemet Matëse** të regjistruara për çdo Interkoneksion.

7.3.2 Deri në ora 13:00 të DP të parë pas Ditës D, **OST** do të dakordojë me **OST** fqinjë **Të Dhënat Matëse** për Interkoneksionet e veçanta në përputhje me procedurat e aprovuar të ENTSO-E.


7.3.3 Deri në ora 14:00 të DP të parë pas Ditës D, **OST** do të dakordojë me **OST** fqinje **Të Dhënat Llogaritëse** për çdo **Interkonektor** në përputhje me procedurat



	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 17 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

e aprovuara të ENTSO-E dhe do t'i dorëzojë **Të Dhënat Matëse** nivelit të ardhshëm më të lartë në Piramidën e ENTSO-E.

- 7.3.4 Deri në orën 15:00 të DP të parë pas Ditës D, **OST** do t'i dorëzojë **AAM, Të Dhënat Matëse** për çdo Interkoneksion.
- 7.3.5 **Të Dhëna Matëse** të cilat do t'i dorëzohen **AAM** do të konsiderohen edhe Nominimet e konfirmuara për çdo **Palë Tregtare** në çdo Interkoneksion dhe **Devijimet e Paqëllimshme** të kalkuluara në paragrafin 7.3.3 në përputhje me procedurat e dakorduara me ENTSO-E për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar**. Për nevoja të **Barazimit Përfundimtar** këto **Të Dhënat Matëse** do të konsiderohen si **Të Dhëna Matëse Aktuale**.
- 7.3.6 Kur **OST** nuk mund të arrijë marrëveshje me **OST** fqinje në lidhje me **Të Dhënat Matëse** në Interkoneksion dhe **Devijimet e Paqëllimshme**, **OST** do të bëjë përpjekjet më të mira për t'i dorëzuar **Të Dhënat Matëse** dhe **Të Dhënat Matëse të Përafuara** bazuar në të dhënat e veta. Këto **Të Dhëna Matëse** do të shënjohen me **Kodin e Statusit të Leximit të Njehsorit – E0**.
- 7.3.7 Pasi të jetë arritur marrëveshja me **OST** fqinje për të dhënat relevante, **OST** do t'i dorëzojë **AAM, Të Dhënat Matëse** të azhurnuara. Këto **Të Dhëna Matëse** bëhen Valide dhe të shënjohen me **Kodin e Statusit të Leximit të Njehsorit. A1**
- 7.3.8 Brenda 2 DP nga Dita D, **AAM** do të sigurojë që **Të Dhënat Matëse Aktuale** të validuara ose **Të Dhënat Matëse të Përafuara** do të jenë të disponueshme për **Barazimin Përfundimtar**.
- 7.4 **Validimi i Të Dhënave Matëse nga Njehsorët me Lexim Jo-Interval të OSSh**
- 7.4.1 Ky nen përshkruan procesin e validimit të **Të Dhënave Matëse** nga **Njehsorët me Lexim Jo-Interval** që përdorën për llogaritjen e **Sasisë Vjetore të Konsumatorëve të Kualifikuar** që nuk kanë **Njehsorët me Lexim Interval**
- 7.4.2 Kur **OSSH** të ketë bërë shkarkimin e **Të Dhënave Matëse** nga **Njehsorët me Lexim Jo-Interval** për validim ai do t'ia dorëzojë të **Regjistruarit një Raport të Të Dhënave Matëse** brenda 1 DP pas leximit të **Njehsorëve**.
- 7.4.3 **Sistemet Matëse** që mbulohen me këtë nen janë **Pikat e Furnizimit** të pajisura me **Njehsor me Lexim Jo-Interval** të kyçura në **Sistemin e Shpërndarjes**.
- 7.4.4 **Të Dhënat Matëse** do të validohen duke përdorë testimet vijuese. **Të Dhënat Matëse** do të jenë të **Dhënat Matëse me Gabim** nëse:
- (a) Numri i ID të **Sistemit Matës** nuk përputhet me numrin e ID të **Sistemit Matës** të regjistruar.

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 18 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) Data e leximit të **Njehsorit** është para datës së leximit të fundit valid të **Njehsorit**.
- (c) **Avancimi i Njehsorit** d.m.th. diferenca ndërmjet leximit të fundit dhe leximit të parafundit është zero
- (d) **Avancimi i Njehsorit** është negativ.

Duhet të bëhet edhe një verifikim shtesë për t'u siguruar që funksionimi i saktë i **Njehsorit** është konstatuar. Në qoftë se funksionimi i **Njehsorit** është i dyshimtë, validimi duhet të përsëritet dhe leximi të shënjohe si valid.


Kur leximi i fundit ishte një lexim i përafëruar dhe avancimi i kalkuluar është negativ, avancimi i kalkuluar nga leximi i fundit aktual valid duhet të përafërohet. Në qoftë se avancimi i kalkuluar është pozitiv, atëherë leximi i fundit duhet të shënjohe si valid dhe leximet e përafëruara duhet të tërhiqen.

- (e) Avancimi i Kalkuluar është më i madh se dy herë avancimi i pritur.
- (f) **Të Dhënat Matëse** periodike janë jashtë brezit të leximit të definuar në **Kodin e Matjes** për atë lloj të **Njehsorit**.
- (g) Data e leximit të regjistrave të **Njehsorëve** ndryshon prej **Njehsorëve** me shumë regjistra.
- (h) Janë regjistruar gabime në **Njehsor**.
- (i) Kur **OSSH** ka ndonjë arsye tjetër të dyshojë se **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë të gabuara.

7.4.5 **OSSH** do t'i dorëzojë **Të Regjistruarit** një **Raport të Të Dhënave Matëse** të regjistruara. **Të Dhënat Matëse** do të shënjohe si valide ose si jo-valide me një kod të gabimit kur **Të Dhënat Matëse** dështojnë gjatë validimit me arsyetimin përkatës. Lista e Kodeve të Gabimeve është dhënë në Shtojcën B.

## 8 Zëvendësimi i Të Dhënave Matëse

- 8.1.1 Në rastet kur **Të Dhënat Matëse** nga **Njehsori** Kryesor nuk mund të përdoren për përcaktimin e **Avancimit të Njehsorit**, atëherë mund të përdoren të dhënat nga **Njehsori** Kontrollues, **Njehsori** Sekondar Kryesor (kur ekziston) ose **Njehsori** Sekondar Kontrollues (kur ekziston) (renditur sipas përparësisë) të përcjella me Kodet për Zëvendësimin e të Dhënave të dhëna në Shtojcën A.
- 8.1.2 Në rastet kur **Të Dhënat Matëse** nga **Njehsori** Kryesor nuk mund të përdoren për përcaktimin e **Avancimit të Njehsorit**, dhe të dhënat përkatëse nga **Njehsori** Kontrollues, **Njehsori** Sekondar Kryesor (kur ekziston) ose **Njehsori** Sekondar Kontrollues (kur ekziston) nuk janë të disponueshme, atëherë mund të përdoren të dhënat ekuivalente nga sistemi SCADA i **OST** nëse janë të disponueshme dhe

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 19 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

do të shoqërohen me Kodet për Zëvendësimin e të Dhënave të dhëna në Shtojcën A.

## 9 Përafrimi i Leximeve të Njehsorëve

9.1.1 Përveç asaj që kërkohet në nenin 9.2, objektivi kryesorë e procesit të përafrimit është përcaktimi i vlerës më të saktë të mundshme që mund të përdoret në procesin e **Barazimit Përfundimtar** për të fituar rezultate të drejta dhe të arsyeshme për të gjitha palët.

### 9.2 Rastet Speciale të Përafrimit

9.2.1 Kur të dhënat janë jo-komplete ose të dhënat dështojnë në validim sipas kësaj procedure, dhe **ORr** është i parandaluar për hulumtimin e shkaqeve, riparimin e defekteve të identifikuar, shkarkimin manual të të dhënave ose nga ndërmarrja e cilitdo testim të kërkuar, në [tri] tentime në kohë të arsyeshme, atëherë **ORr** do t'ia paraqes këtë **Sistem Matës, OT, AAM dhe ZRrE** si rast special të përafrimit. Pas identifikimit si rast special, përafrimi do të bëhet si është përkufizuar në këtë nen.

9.2.2 Procedura Speciale për Përafrimin e Injektiveve të Gjenerimit

9.2.3 Deri sa Sistemi Matës nuk është më rast i përafrimit special, **ORr** relevant të gjitha injektimet do t'i përafroj në zero. Procedura Speciale për Përafrimin e rrjedhave të energjisë dalëse të konsumit (duke përfshirë edhe rrjedhat e energjisë kah rrjeta e **OSSh**).


**ORr** duhet të përcjellë procedurën për përafrim të përshkruar në këtë procedurë dhe duhet të dyfishojë vlerën e gjithmbarshme para se t'ia dorëzojë atë **AAM** dhe cilësdo pale tjetër relevante.

9.2.4 Kur aplikohen masat e përshkruara në nenin 9.2.2 ose 9.2.3, duhet të konsultohet **ZRrE**.

### 9.3 Kalkulimi i Të Dhënave Matëse

9.3.1 Aty ku **Të Dhënat Matëse Aktuale** janë të disponueshme për të gjitha injektimet dhe të gjitha daljet në një pjesë të rrjetit për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar** të caktuar, **Të Dhënat Matëse të Përafuara** për atë **Periodë të Barazimit Përfundimtar** për kyçjet e mbetura do të kalkulohen nga diferenca e vlerave të matura.

9.3.2 Aty ku shfrytëzuesi i sistemit mund të përcaktojë rrjedhat e energjisë në rrjetën e tij ashtu që është e mundur të përcaktohen rrjedhat korresponduese të energjisë në kufirin komercial, këto të dhëna mund të përdoren nga **ORr** për kalkulimin e

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 20 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

avancimit të përafuar të **Njehsorit**. Në qoftë se kërkohet nga **AAM**, kalkulimi i faktorit përkatës të humbjeve do të jetë përgjegjësi e **ORr**.

9.3.3 Aty ku janë të disponueshme avancimet kumulative përveç avancimit për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar, ORr** do të bëjë kalkulimin e avancimit periodik të përafuar përmes të dhënave të disponueshme.

#### 9.4 Përafrimi i më Pakë se 9 Vlerave Intervale të Njëpasnjëshme

9.4.1 Kur mungojnë më pak se 9 vlera intervale të njëpasnjëshme, **ORr** duhet të përdorë interpolimin linear për të bërë përafrimin e vlerave të kërkuara duke u bazuar në vlerat intervale kufitare valide dhe avancimin kumulativ kur është në dispozicion.

#### 9.5 Përafrimi i më Shumë se 8 Vlerave Intervale të Njëpasnjëshme

9.5.1 Kur mungojnë më shumë se 8 vlera intervale të njëpasnjëshme, **ORr** duhet të krijojë një profil të përafuar të të dhënave intervale duke u bazuar në:

- (a) Avancimin kumulativ kur është i disponueshëm;
- (b) Të dhënat e njohura operative të sistemit;
- (c) Profilin për atë lokacion për të njëjtën kohë, për të njëjtën ditë të javës së kaluar dhe/ose;
- (d) Profilin e pjesës së mbetur të sistemit.


9.5.2 Në rastet kur dita për të cilën kërkohen përafrimet është festë publike, përveç në qoftë se është ditë e punës për lokacionin për të cilin kërkohen përafrimet, duhet të përdoret profili për Të Dielën e Kaluar në vend të profilit të të njëjtës ditë të javës së kaluar.

9.5.3 Në rastet kur dita për të cilën kërkohen përafrimet nuk është festë publike por dita e njëjtë e javës së kaluar ishte festë publike, duhet të krijohet një profil mesatar:

- (a) Për të hënë, nga tri të hënat e kaluara punuese;
- (b) Për të premten, nga tri të premtet e kaluara punuese;
- (c) Për të martën, të mërkurën ose të enjten, nga tri të martat, tri të mërkurat dhe tri të enjtet e kaluara punuese.

#### 9.6 Të Dhënat Matëse të Gjeneratorëve

9.6.1 Kur është i nevojshëm përafrimi i **Të Dhënave Matëse** në lidhje me **Pikën e Kyçjes** së gjeneratorit, përveç ku ekzistojnë fakte për një regjim të ndryshëm të

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 21 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

operimit, gjatë përcaktimit të vlerave që duhet të aplikohen për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar**, vëmendja do të përqendrohet tek nominimet që i janë dorëzuar **OST** dhe urdhëresat e dhëna nga **OST**.

## 9.7 Përafrimi i Energjisë Reaktive

9.7.1 Kur është i nevojshëm përafrimi **Energjisë Reaktive**, do të përdoret mënyra e qasjes si në nenin 9 përveç se nuk do të bëhen përafrime për ndonjë lokacion ku Regjistrat e **Energjisë Reaktive** nuk janë të regjistruar në **Informatat Teknike të Njehsorit** për atë **Pikë të Kyçjes**.

## 9.8 Të Dhënave Matëse për Konsumatorët e Kualifikuar me Njehsor me Lexim Jo-Interval

9.8.1 Në baza mujore, **AAM** duhet të kalkulojë përpjesën vjetore,  $HV_D$ , për çdo ditë për muajin e ardhshëm si:

$$HV_D = \frac{KM_D}{\sum KM_D}$$

ku  $KM$  = konsumi mesatar në Ditën “D” për [5] vitet e kaluara

dhe shuma  $KM$  është për të gjitha ditët D në vitin paraprak.

9.8.2 **AAM** do t’i siguroj **OSSH** Herësat Vjetor për vitin pasues deri në ditën e 10 të muajit të fundit të periodës së kaluar gjashtë mujore.

9.8.3 **OSSH** do të caktoj avancimin e pritur ( $AP$ ), për këtë pozicion si:


$$AP = \sum HV_D \times SVE$$

ku, shuma  $HV$  është realizuar në periodën e avancimit

dhe  $SVE$  është **Sasia Vjetore e Energjisë** e përcaktuar sipas paragrafit 16.4 të **Rregullave të Tregut**.

## 10 Hulumtimi i Shkaqeve të Dështimit të Validimit

10.1.1 Kur dështon validimi i **Të Dhënave Matëse** i realizuar në përputhje me kërkesat e nenit 7, duhet të hulumtohet shkaku në terren, sipas mundësisë në prezencën e **Palëve Tregtare** dhe/ose shfrytëzuesve të sistemit që janë të ndikuar direkt. Përveç në qoftë se identifikohet një shkaktarë i qartë, **Sistemi Matës** do të testohet si përcaktohet në nenin 11.5 të **Kodit të Matjes** ose nenit 4.9 të **Kodit të Matjes** së **OSSH** sipas rastit.

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 22 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

## 11 Vizitat në Terren

11.1.1 **Shfrytëzuesit e Sistemit**, ose personat tjerë që kontrollojnë cilindo **Sistem Matës** në terren duhet të lejojnë qasjen në atë **Sistem Matës** përfaqësuesve të:

- **ORr** në rrjetin e të cilëve **Sistemi Matës** është i **Kyçur**;
- **ORr** ose cilido agjent i **ORr** që është përgjegjës për sigurimin e shërbimeve matëse në **Pikën e Kyçjes**;
- **Operatorit të Tregut**; dhe
- **Furnizuesit** përgjegjës për furnizim me energji përmes **Sistemit Matës** në rastin e një shfrytëzuesi të sistemit që është **Konsumator**, **Furnizuesi** duhet të sigurohet që **Konsumatori** ka një obligim kontraktual për të mundësuar qasjen përfaqësuesve të organizatave të numëruara më lartë;


për të inspektuar, mirëmbajtur ose grumbulluar të dhënat nga **Sistemi Matës**.

11.1.2 Sa herë që vizitojnë vendndodhjen e **Sistemeve Matëse**, përfaqësuesit e **OST** do të veprojnë në përputhje me Kodin e Punës për Qasje në Tokë dhe Ndërtesa dhe përfaqësuesit e **OSSH, OT** ose **Furnizuesit** do të:

- bartin rroba dhe shfrytëzojnë automjete, sa herë që është e mundur, që identifikojnë kompaninë për të cilën ata punojnë;
- tregojnë kartelat identifikuese të lëshuara nga kompania e tyre. Këto kartela duhet të tregojnë emërtimin e kompanisë; emrin dhe nënshkrimin e përfaqësuesit; numrin e punës së përfaqësuesit; fotografinë me ngjyra të përfaqësuesit së paku me madhësi të kërkuar për një pasaportë ndërkombëtare; datën e skadimit të kartelës që nuk guxon të jetë me afat më e shkurtër se dy vjet; dhe një numër telefoni i cili mund të përdoret për konfirmimin e përfaqësuesit dhe arsyes së vizitës;
- ndërmarrin të gjitha punimet në përputhshmëri me kërkesat për sigurinë në punë [rregullat për sigurinë në instalimet elektrike]; dhe
- të jenë në përputhshmëri me të gjitha udhëzimet relevante të sigurisë që aplikohen në **Sistemet Matëse** dhe për një lokacion specifik.

11.1.3 Gjatë vizitave në terren, në **Pikat e Kyçjes** ku janë të instaluara **Sistemet Matëse Interval**, nga ana e përfaqësuesve të **ORr, OT** dhe **Furnizuesit** do të ndërmerren verifikimet vijuese:


- Nëse **Sistemi Matës** është/duhet të jetë i **Energjizuar** ose **De-energizuar**.

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 23 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- Konfirmoj se regjistrat kohor/(ndryshimi i kohës) janë sinkronizuar në kohë.
- Kërkoj ndonjë dëshmi që sugjeron ekzistencën e ndonjë gabimi në **Sistemin Matës** duke përfshirë ndonjë prishje fazore ose rënie të siguresave.
- Kërkoj ndonjë dëshmi për dëmtimin e **Sistemit Matës** ose **Kyçjes në Rrjet**.
- Kërkoj ndonjë dëshmi për keqpërdorim – sidomos për pllombat e **Njehsorëve** dhe pllombat e terminaleve të **Kyçjeve**/bornave kyçëse.
- Kërkoj ndonjë dëshmi për **Njehsorë** që nuk kanë regjistruar avancimin në rastin e lokacioneve me personel.
- Kërkoj ndonjë dëshmi që furnizimi është bërë deri sa **Njehsori** ka qenë i **De-energizuar**.

11.1.4 Gjatë vizitave në terren, në **Pikat e Kyçjes** ku janë instaluar **Sistemet Matëse Jo-Interval**, nga ana e përfaqësuesve të **ORr, OT** dhe **Furnizuesit** do të ndërmerren verifikimet vijuese:

- Nëse **Sistemi Matës** është/duhet të jetë i **Energjizuar** ose **De-energizuar**.
- Ku është e mundur, numrin e resetimeve të regjistrit të konsumit maksimal.
- Nëse regjistri maksimal i kërkesës është në shkallë të plotë.
- Konfirmoj se regjistrat kohorë/(ndryshimi i kohës) janë sinkronizuar në kohë korrekte.
- Kërkoj ndonjë dëshmi që sugjeron ekzistencën e ndonjë gabimi në **Sistemin Matës** duke përfshirë ndonjë prishje fazore ose rënie të siguresave.
- Kërkoj ndonjë dëshmi për dëmtimin e **Sistemit Matës** ose **Kyçjes në Rrjet**.
- Kërkoj ndonjë dëshmi për keqpërdorim – sidomos për pllombat e **Njehsorëve** dhe pllombat e terminaleve të **Kyçjeve**.
- Kërkoj ndonjë dëshmi që **Njehsori** nuk është duke regjistruar avancimin në rastin e lokacioneve me personel.
- Kërkoj ndonjë dëshmi që furnizimi është bërë deri sa **Njehsori** ka qenë i **De-energizuar**.

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 24 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

## 11.2 Zbulimi i Keqpërdorimit të Njehsorëve dhe Vjedhjeve të Energjisë Elektrike

11.2.1 Aty ku janë identifikuar keqpërdorime të **Njehsorit** dhe vjedhje të energjisë elektrike, **Shfrytëzuesit e Sistemit** ose **Furnizuesi** duhet të njoftoj **ORr** i cili do të:

- Rekomandoj që të zëvendësohen të gjitha leximet e dorëzuara nga leximi i fundit,
- Kalkuloj dhe dorëzoj vlerat e përafuara të gjitha **Palëve** relevante për:
  - a. Konsumin për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** në rastin e **Njehsorëve me Lexim Interval**,
  - b. Avancimet e **Njehsorëve**, regjistrin e leximeve dhe, konsumin që i alokohet çdo **Periode të Barazimit Përfundimtar**, duke u bazuar në avancimet e reviduara të **Njehsorëve**, në rastin **Njehsorëve me Lexim Jo-Interval**.

11.2.2 Në rastin e **Njehsorëve** që janë lexuar nga largësia përmes leximit automatik, data e leximit të **Njehsorit** valid të fundit do të konsiderohet data e fundit nga:

- data e testimit të fundit të komunikimit ose konfirmimit të leximeve, dhe
- data e leximit të **Njehsorit** të përafuar të parë pas datës e cila është [një] vit kalendarik para datës në të cilën është zbuluar gabimi.


11.2.3 Në rastin e **Njehsorëve** që janë lexuar në mënyrë manuale në terren ose në mënyrë elektronike, data e fundit valide e leximit të **Njehsorit** do të konsiderohet data e fundit nga:

- data e leximit të fundit në terren dhe nga ana e **ORr**, dhe
- data e parë e leximit të **Njehsorit** e përafuar ose leximet e **Njehsorit** të dorëzuara nga **Shfrytëzuesi i Sistemit** ose **Furnizuesi** pas datës e cila është [një] vit kalendarik para datës në të cilën është zbuluar gabimi.

11.2.4 Kur kalkullohet vlera e konsumit të përafuar për të gjitha ditët pas datës së leximit valid të **Njehsorit** deri në ndalimin e keqpërdorimit të **Njehsorit** ose vjedhjeve të energjisë elektrike, **ORr** do të :

- Përdorë çdo model të konsumit të lejuar me **Rregullat e Tregut**, me këto **Procedura të Rregullave të Tregut**, me marrëveshjen për furnizim me energji ose me Marrëveshjen për Kyçje.



	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 25 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

11.2.5 Aty ku një **ORr** siguron kalkulimet e reviduara të konsumit gjatë çdo **Periode të Barazimit Përfundimtar** ose avancimit të regjistrit të **Njehsorit, OSSh** do të jetë përgjegjës për saktësinë e kalkulimeve në përputhje me kërkesat e nenit 11.2 dhe nenit **9**. Përgjegjësia për sigurimin e të gjitha dëshmive që mund të kërkohen më vonë nga ana e gjyqit do të bie mbi personin i cili ka identifikuar keqpërdorimin e **Njehsorit** ose ndonjë vjedhje tjetër.

## 12 Dispozitat Kalimtare

12.1.1 Validimi i **Të Dhënave Matëse** të **OST** në përputhje me këtë procedurë duhet të filloj pas datës në të cilën **ZRrE** e aprovon implementimin e kësaj procedure dhe nga data e hyrjes në fuqi të Versionit 2.0 të **Rregullave të Tregut**.

12.1.2 Validimi i **Të Dhënave Matëse** të **OSSH** në përputhje me këtë procedurë duhet të filloj pas datës në të cilën **ZRrE** e aprovon implementimin e kësaj procedure; gjegjësisht implementimi nga **AAM**; fillimi i konkurrencës në furnizim në Nivelin e Shpërndarjes dhe data e hyrjes në fuqi të Versionit 2.0 të **Rregullave të Tregut**.

12.1.3 Derisa të filloj konkurrenca në furnizim, validimi i matjeve në shpërndarje për nevoja të **Barazimit Përfundimtar** nuk do të nevojitet pasi që supozohet se të gjithë konsumatorë nën kufirin Tx/Shx do të furnizohen nga ana e **Furnizuesit Publik**.

## 13 Situatat Emergjente dhe Mosmarrëveshjet


13.1.1 Kur të ndodhë ndonjë dështim me përmasa më të mëdha në sigurimin e **Të Dhënave Matëse** për **OT**, atëherë **OT** në konsultim me **ZRrE** dhe **Panelin Shqyrtues** do të:

- (i) vlerësoj ndikimin e vonësive të dorëzimit të **Të Dhënave Matëse** në realizimin e **Barazimit Përfundimtar**;
- (ii) vlerësoj ndikimin në ekzekutimin e **Barazimit Përfundimtar** me zëvendësimin e **Të Dhënave Matëse** me të dhënat e muajit të kaluar ose të dhënat e një muaji të ngjashëm nga viti i kaluar; ose
- (iii) kërkoj një zgjidhje tjetër alternative.


13.1.2 Pas procesit të referuar në 13.1.1 **OT** do të realizoj **Barazimin Përfundimtar** në përputhje me rezultatet e konsultimeve.

13.1.3 Mosmarrëveshjet që ngritën pas futjes në operim të kësaj **Procedure të Rregullave të Tregut** do të zgjidhen në përputhje me procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashtruar në Nenin 21 të **Rregullave të Tregut**.

13.1.4 Pas përfundimit të procesit të zgjidhjes së ndonjë **Mosmarrëveshjeje**, ku nevojiten, **Të Dhënat Matëse** do të azhurnohen në përputhje me **Procedurën e**

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 26 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

**Rregullave të Tregut** dhe çdo pasojë në **Barazimin Përfundimtar** do të sanohet në përputhje me **Procedurën të Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve**.

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 27 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

## 14 Shtojca A


### *Kodet Zëvendësuese për Njehsorët me Lexim Interval*

Kodi i statusit të leximit	Arsyeja për Zëvendësim	Metoda e Përdorur
A	Mungojnë ose janë të gabuara <b>Të Dhënat Matëse</b> nga <b>Njehsori</b> Kryesor, janë në disponim <b>Të Dhënat Matëse</b> nga <b>Njehsori</b> Kontrollues	Kopjohen nga <b>Njehsori</b> Kontrollues
B	Mungojnë ose janë të gabuara <b>Të Dhënat Matëse</b> nga <b>Njehsori</b> Kryesor ose nga <b>Njehsori</b> Kontrollues në Grumbulluesin e të Dhënave Primar, janë në disponim të Dhënat Matëse në Grumbulluesin e të Dhënave Sekondar kryesore.	Kopjohen nga <b>Njehsori</b> Sekondar Kryesor
C	Mungojnë ose janë të gabuara <b>Të Dhënat Matëse</b> nga <b>Njehsori</b> Kryesor dhe nga <b>Njehsori</b> Kontrollues në Grumbulluesin e të Dhënave Primar, janë në disponim të Dhënat Matëse në Grumbulluesin e të Dhënave Sekondar kontrollues	Kopjohen nga <b>Njehsori</b> Sekondar Kontrollues
D	Mungojnë ose janë të gabuara <b>Të Dhënat Matëse</b> nga <b>Njehsori</b> Kryesor ose nga <b>Njehsori</b> Kontrollues në Grumbulluesin e të Dhënave Primar dhe të Dhënat Matëse në Grumbulluesin e të Dhënave Sekondar nuk janë në disponim, por ekzistojnë të dhënat nga SCADA	Kopjohen nga të dhënat e SCADA

Vërejtje: Opsionet A – C nuk mund të përdoren në qoftë se të dhënat zëvendësuese dështojnë në cilëndo nga rregullat e miratimit nga neni 6.

### *Kodet e Përafrimit për Njehsorët me Lexim Interval*

Kodi i statusit të leximit	Arsyeja për Përafrim/ Zëvendësim	Metoda e Përdorur
E	<b>Përafrimi Special - Gjenerim:</b>	<b>Përafrimi</b> Manual në zero
F	<b>Përafrimi Special - Konsumi:</b>	Shënjimi Special i Përafrimit – që duhet të përcillet me kodin e metodës së përafrimit
G	<b>Nuk ka të dhëna nga lokacioni gjegjës,</b>	<b>Kalkulohet në bazë të Rrjedhave</b>

	<b>Procedura e Rregullave të Tregut për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve</b>	<b>PR-MO-006</b>
	<i>versioni. 1.0</i>	<i>Faqe 28 nga 28</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

	por janë në disponim të dhënat nga të gjitha pikat fqinje në nivel të njëjtë të tensionit	të energjisë në Rrjet – nuk ka faktor të korigjimit
H	Nuk ka të dhëna nga lokacioni gjegjës, por janë në disponim të dhënat nga pikat fqinje	Kalkulohet në bazë të Rrjedhave të energjisë në Rrjet –kërkohet faktori i korigjimit
J	Janë të disponueshme avancimet kumulative dhe të gjitha avancimet periodike përveç 1 avancimi periodik	Kalkulohet 1 avancim periodik
K	Më pakë se 9 avancime periodike	Profilizimi përmes interpolimit linear
L	Më shumë se 8 avancime periodike	Profilizimi përmes trendit
U	Përdorimi i leximeve të vet palës	Përafrimi Manual
X	Përdorimi i metodës tjetër të përafrimit	Përafrimi Manual

## 15 Shtojca B

### *Kodet e Përafrimit për Njehsorët me Lexim Jo-Interval*

Kodi i statusit të leximit	Arsyeja për Lexim Jo-valid
A	Mospërputhja e ID të <b>Sistemit Matës</b>
B	Data e leximit të <b>Njehsorit</b> është para datës së leximit valid të <b>Njehsorit</b>
C	Avancim zero
D	Avancim Negativ <sup>1</sup>
E	Avancim dy herë më i madh se ai i pritur
E	Avancimi i kalkuluar tejkalon mundësinë e leximit të <b>Njehsorit</b>
F	Të dhënat e lexuara të <b>Njehsorit</b> për <b>Njehsor</b> me shumë regjistra ndryshojnë
G	Janë regjistruar gjurmë të gabimeve në <b>Njehsor</b>
X	Arsye tjera <sup>2</sup>

<sup>1</sup> Avancimi i pritur do të jepet në **Raportin e Të Dhënave Matëse**.

<sup>2</sup> Arsyet tjera të tregohen në **Raportin e Të Dhënave Matëse**.